



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRRI

01 Nr. / Br 72/21

Nr. i fq. / Br. st - 10 -

Data / Datum 25. 03. 2021

VUSHTRRI - VUÇITRRI



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

---

**STATUTI**  
**I QENDRËS PËR PUNË SOCIALE**

**Vushtrri mars 2021,**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 2 shkronja “d” në lidhje me dispozitat e nenit 17, paragrafi 1 shkronja “k” të Ligjit, Nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 6 dhe 7 të Ligjit, Nr. 02/L-17, për Shërbime Sociale dhe Familjare, dispozitave të nenit 41 paragrafi 2 shkronja ”d” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Nr.58/2011, të miratuar me datën 28.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25 mars 2021** aprovon:

## **STATUTIN E QENDRËS PËR PUNË SOCIALE**

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij Statuti është që të krijojë një kornizë rregullative për organizimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Qendrës për Punë Sociale, në përputhje me legjislacionin dhe nevojat e komunitetit.

### **Neni 2 Përkufizimi**

1. Statuti i Qendrës për Punë Sociale në Vushtrri, është akti më i lartë juridik i këtij Institucioni, me të cilin rregullohet emërtimi, selia, rregullimi i brendshëm, struktura dhe funksionimi i Qendrës për Punë Sociale.
2. Sipas këtij Statuti, Qendra për Punë Sociale (në tekstin e mëtejshëm QPS), është Institucion publik i mbrojtjes sociale që ofron shërbime sociale dhe familjare dhe ndihmë financiare/materiale për rastet në nevojë sociale, brenda territorit administrativ të Komunës.

### **Neni 3 Objekti i Rregullimit**

Me këtë Statut rregullohet: Nocioni, emërtimi, selia, simbolet, statusi juridik prezantimi dhe përfaqësimi, funksionimi i veprimtarisë dhe përgjegjësitë e Qendrës për Punë Sociale, mbikëqyrja e brendshme struktura organizative e institucionit, udhëheqja dhe trupat e saj, organizimi sindikal, pronësia, buxheti, financat, transparenca, konfidencialiteti, përcaktohet dhe rregullohet kompetenca ligjore, administrative dhe profesionale në ushtrimin e veprimtarisë së përkujdesjes sociale dhe familjare në Qendrën për Punë Sociale.

### **Neni 4 Qendra për Punë Sociale**

1. Sipas këtij Statuti, Qendra për Punë Sociale (QPS) është institucion publik profesional i nivelit Komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale, brenda territorit administrativ të komunës.
2. Qendra për Punë Sociale kujdeset që banorët e saj në nevojë për shërbime sociale t'i gëzojnë të drejtat e tyre për shërbime, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni, dhe

orientime tjera, me qëllim që çdo person apo familje në nevojë, e cila është banore e komunës, apo gjendet në territorin e Komunës së Vushtrrisë të ketë qasje të barabartë në marrje të shërbimeve sociale, në kuadër të kompetencës ligjore në përkujdesje sociale.

## **Neni 5**

### **Statusi Juridik, prezantimi dhe përfaqësimi**

1. QPS, është institucion i cili bënë pjesë në rrjetin e institucioneve të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale.
2. QPS, kryen dhe ofron shërbime të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale për personat dhe familjet në nevojë, sipas parimit të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale, të përcaktuar në dispozitat e këtij Statuti, të Ligjit për Shërbime Sociale dhe familjare, Ligjit për Familjen i Kosovës dhe Ligjin mbi Skemës se Ndhimave Sociale 2003/15 si dhe Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhimës Sociale në Kosovë dhe të akteve tjera nënligjore.
3. Për nënshkrimin e kontratave, me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet, pajisjet (kapitale) të QPS-së, QPS së pari, duhet ta ketë miratimin e Kuvendit Komunal.
4. Në rast të nënshkrimit të kontratave QPS, paraqitet si subjekt i pavarur juridik, bazuar në Ligjin për Prokurim Publik dhe aktet nënligjore të cilat i nxjerrë Ministria e Financave.
5. Për përgjegjësitë e marra financiare, QPS përgjigjet me tërë pasurinë e saj.
6. Qarkullimi i mjeteve financiare bëhet përmes kodit buxhetor të QPS-së, përmes xhirollogarisë së Komunës.
7. Drejtori i QPS-së ka të gjitha autorizimet për përfaqësim juridik brenda veprimtarisë së QPS-së, duke marrë parasysh përkufizimet ligjore dhe Statutin.

## **Neni 6**

### **Emërtimi, selia dhe simbolet**

1. Emri i Institucionit është: Qendra për Punë Sociale –Vushtrri.
2. Selia e Qendrës për Punë Sociale, është në Vushtrri, rruga “Fatime Hyseni” Nr.4
3. Emërtimi i institucionit të Qendrës për Punë Sociale vendoset në Objekt të QPS-së dhe në objektet e degëve të saja, shkruar në gjuhët zyrtare në përdorim në Kosovë.
4. Për ndryshimin e emrit dhe të selisë së Qendrës për Punë Sociale, vendos Kuvendi i Komunës.
5. QPS në komunikim zyrtar, bartë stemën e Komunës së Vushtrri dhe të Republikës së Kosovës.

## **Neni 7**

### **Vulat dhe përmbajtja në qarkullim juridik**

1. QPS, ka vulën e saj të rrumbullakët dhe katrore, që në qarkullim juridik paraqitet si: Qendra për Punë Sociale në Vushtrri.
2. Vula e rrumbullakët është e dizajnuar në bazë të ligjit për vula në institucionet e Kosovës, Nr.03/L – 054, me diametër 40 mm, dhe ka këtë përmbajtje:
  - 1.1. Rrethi i parë: Republika e Kosovës,
  - 1.2. Rrethi i dytë: Komuna Vushtrri,

- 1.3. Rrethi i tretë: Qendra për Punë Sociale,
  - 1.4. Në mes të vulës është emblema e Komunës.
3. Vula katrore e pranimit dhe e dorëzimit, është e rregulluar me ligjin për vula, është e madhësisë 70 mm x 40mm, dhe ka këtë përmbajtje:
    - 3.1. Republika e Kosovës,
    - 3.2. Komuna Vushtrri,
    - 3.3. Qendra për Punë Sociale në Vushtrri,
    - 3.4. Njësia organizative, numri dhe data e evidencës si dhe numri i faqeve të aktit.
  4. Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit dhe selinë, të shkruar në gjuhë zyrtare që janë në përdorim në territorin e Komunës.
  5. Drejtori i QPS-së, vendos për mënyrën e përdorimit të vulave dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtjen e tyre.

### **Neni 8**

#### **Veprimtaria e QPS-së**

1. Veprimtaria e QPS-së, përfshinë ofrimin e përkujdesjes dhe mirëqenies sociale për banorët e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, përmes ofrimit dhe zbatimit të konceptit të punës sociale dhe mirëqenies sociale në kuadër të sistemit unik të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale në Republikën e Kosovës.
2. Koncepti i përkujdesjes sociale konsiston në atë që banorëve të komunës t’iu ofrojë përkujdesje dhe mirëqenie sociale, këshillime gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuar në të dhëna shoqërore: psikologji, sociologji, drejtësi, pedagogji, përmes caktimit të ekspertëve profesional, të cilët për rastet në nevojë sociale do të jenë të domosdoshëm në sistemin e përkujdesjes sociale dhe të mirëqenies sociale dhe njëherësh pikë referuese për specialistët konsultant në përkujdesjen dhe mirëqenien sociale.
3. Përkujdesja dhe mirëqenia sociale në QPS sigurohet dhe zbatohet nga zyrtarët e shërbimeve sociale, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me dispozitat e ligjeve në fuqi që rregullojnë marrëdhënien e punës në Kosovë.
4. Caktimi i zyrtarëve, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre rregullohen sipas standardëve të përcaktuara nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejme MFPT).

### **Neni 9**

#### **Përgjegjësia dhe veprimtaria e QPS-së**

1. QPS është përgjegjëse:
  - 1.1. Për ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit, ndihmës financiare/materiale, për rastet me nevojë sociale brenda territorit të Komunës;
  - 1.2. Të ju përmbahet rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara me ligj;
  - 1.3. Të lejojë marrjen e përgjegjësive nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – Komuna;

- 1.4. Për menaxhimin e fondeve vjetore nga MFPT si dhe nga Komuna;
  - 1.5. Të zhvilloj aktivitete me qëllim të sigurimit të fondeve apo ndihmave tjera materiale për organizatat joqeveritare që merren me këto veprimtari.
2. QPS ushtron këto veprimtari:
- 2.1. Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të Komunës, sipas standardeve të përcaktuara nga MFPT;
  - 2.2. Bënë administrimin dhe kujdeset për funksionimin e Skemës së Ndhimave Sociale;
  - 2.3. Ndërmerr hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të Komunës;
  - 2.4. Përgatit planin vjetor të punës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare;
  - 2.5. Mban shënime e statistika, të cilat paraqesin të dhënat e aktiviteteve për përkujdesje sociale dhe familjare;
  - 2.6. Përbush detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve për përkujdesjen sociale dhe mirëqenien sociale, të përcaktuara me dispozitat ligjore dhe të akteve nënligjore;
  - 2.7. Bashkëpunon ngushtë me DSHMS-në dhe MFPT -në, me qëllim të realizimit të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale;
  - 2.8. Ushtron veprimtari tjera të parapara me vendimet e Kuvendit Komunal.

#### **Neni 10**

#### **Struktura organizative e institucionit**

1. QPS, për ta realizuar funksionin e përkujdesjes dhe mirëqenies sociale të banorëve, është organizuar në shërbimet si vijon:
  - 1.1. Shërbimi Social,
  - 1.2. Shërbimi i Asistencës Sociale,
  - 1.3. Shërbimi Administrativ/Financiar.
2. Qendra për Punë Sociale ka të rregulluar edhe sistemin e evidencës elektronike, përpunimit të dhënave përmes data bazave përkatëse në kudër të shërbimeve.

#### **Neni 11**

#### **Funksioni dhe menaxhimi i Shërbimeve të ofruara**

1. Shërbimi Social, është shërbim profesional në kuadër të QPS-së, dhe luan rolin e Organit të Kujdestarisë, sipas nenit 7, pika 2, të Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare.
2. Shërbimi i Asistencës Sociale, është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Skemës së Ndhimave Sociale, skemë të cilën e financon dhe menaxhon MFPT.
3. Shërbimi Administrativ-Financiar, është përgjegjës për administrimin e buxhetit dhe financave të institucionit të QPS-së, si dhe punëve teknike e administrative.
4. Shërbimet e QPS-së, menaxhohen nga udhëheqësit e shërbimeve.
5. Udhëheqësit e shërbimeve zgjedhën më konkurs, sipas Ligjit Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

6. Kriteret më të hollësishme mbi organizimin e brendshëm të QPS-së, dhe shërbimeve të saja, përcaktohen me Vendimin mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

#### **Neni 12**

#### **Udhëheqja dhe trupat e QPS - së**

1. QPS, ka Këshillin e ekspertëve, i cili e drejton aktivitetin e QPS-së, nën udhëheqjen e Drejtorit;
2. Këshillin e ekspertëve e përbëjnë të punësuarit profesional në Sektorin e shërbimeve sociale;
3. Këshilli i ekspertëve kryen punët, të cilat parashihen me dispozitat e nenit 7, pika 7.9 të Ligjit të Shërbimeve Sociale dhe Familjare dhe atë:
  - 3.1. Punën profesionale dhe aktivitete specifike brenda QPS-së, të përcaktuara me Ligj dhe rregullore,
  - 3.2. Organizimin e QPS-së,
  - 3.3. Vështirësitë në zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara profesionale;
  - 3.4. Ushtrimin e të drejtave dhe aktiviteteve tjera në QPS në rastet më të rënda individuale;
  - 3.5. Nevojën për arsimim dhe aftësim shtesë profesional dhe çështje të tjera të parapara me Ligj dhe Statut;
4. Këshilli i ekspertëve konstaton gjendjen faktike familjare, vlerëson rrethanat e rastit dhe i rekomandon Drejtorit marrjen e vendimit që shkon në mbrojtjen dhe interesin më të lartë të fëmijës;
5. Këshilli i ekspertëve mban takime të rregullta për të cilat përgatit procesverbalin i cili shqyrtohet dhe miratohet në takimin e radhës.

#### **Neni 13**

#### **Këshilli i ekspertëve**

1. Këshilli i ekspertëve, me propozimin e drejtorit nxjerr këto akte të QPS-së:
  - 1.1. Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
  - 1.2. Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore të punonjësve;
  - 1.3. Rregulloren për sigurinë në punë;
  - 1.4. Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit;
  - 1.5. Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm;
  - 1.6. Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme.

#### **Neni 14**

#### **Funksioni dhe përzgjedhja e Drejtorit të QPS-së**

1. QPS-në e udhëheq drejtori i QPS-së.
2. Drejtori është përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara për QPS-në. Ai e prezanton dhe përfaqëson QPS-në.

3. Në mungesë të drejtorit, QPS-në, e udhëheqë nëpunësi i autorizuar nga Drejtori i QPS-së.
4. Drejtori i QPS-së, zgjidhet me konkurs publik, në pajtim me Ligjin që rregullon punësimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
5. Drejtor i QPS-së, mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet e caktuara në nenin 7 të Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe duhet të jetë me profesion: jurist, pedagog, sociolog, psikolog, ekonomi, diplomaci, menaxhment, administrata, ose nga ndonjë lëmi tjetër, apo që ka të bëjë me shërbimet sociale dhe familjare dhe të ketë se paku 3 vjet përvojë pune në lëmin e shërbimeve sociale.
6. Vendimin për shpalljen e konkursit për drejtor të QPS-së, e merr Kryetari i Komunës, Bazuar në ligjet dhe aktet normative.

### **Neni 15**

#### **Përgjegjësia e Drejtorit të QPS-së**

1. Drejtori i QPS-së, është përgjegjës për sigurimin e ligjshmërisë dhe punën profesionale të QPS-së, e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi përfshirë edhe të drejtën e vendimmarrjes dhe ankesës si dhe të respektohet Kodi Etik për Ofruesit e Shërbimeve Sociale të Republikës së Kosovës, si dhe të ketë mbështetje në Ligjin Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Drejtori i QPS-së është përgjegjës për përkujdesjen e vazhdueshme dhe efektive të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale për të gjithë personat dhe familjet në nevojë në territorin e komunës së Vushtrrisë dhe i njëjti përgjigjet për detyrat në vijim:
  - 2.1. Në pajtim me politikat e përkujdesjes dhe mirëqenies sociale, Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, i propozon Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale planin e punës dhe buxhetin e QPS-së për vitin vijues;
  - 2.2. Zbatimin e planit të burimeve njerëzore;
  - 2.3. Udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QPS;
  - 2.4. Zhvillimin e marrëdhënieve të mira me donatorët dhe OJQ-të;
  - 2.5. Zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QPS-së;
  - 2.6. Vendosjen e mekanizmave të sigurimit të objektit;
  - 2.7. Dhënien e kontributit për zhvillimin e sistemit të informimit të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale të QPS-së, sipas standardeve të pranuarra dhe sigurimin e mbledhjes së informatave, si dhe avancimin e punës ekipore;
  - 2.8. Realizimin e programit të punës së QPS-së, duke u bazuar në politikat zhvillimore të nxjerra nga MFPT dhe DSHMS.
3. Në programin e vjetor të punës duhet të përcaktohen masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura të kujdesit social dhe familjes në QPS:
  - 3.1. Plani vjetor i punës,
  - 3.2. Burimet njerëzore,
  - 3.3. Plani financiar,
  - 3.4. Raportet mujore e vjetore të punës dhe raportet financiare.
4. Drejtori i QPS-së, për punën e tij i përgjigjet drejtorit të Drejtorisë të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

5. Drejtori i QPS-së, ka për detyrë që gjatë punës t'ia tërheqë vërejtjen Këshillit të ekspertëve lidhur me vendimet që mund të marrë, siç janë:
  - 5.1. Aktet e propozuara të cilat janë në kundërshtim me ligjet relevante, respektivisht aktet e përgjithshme të QPS-së;
  - 5.2. Akti i propozuar, i cili është në kundërshtim me programin e punës së QPS-së;
  - 5.3. Akti i propozuar, i cili nuk i kontribuon çështjes së paraparë për një shërbim të caktuar social.

#### **Neni 16**

#### **Trupat profesionale të QPS-së**

1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, drejtori i QPS-së formon trupa profesionale pranë QPS-së, siç janë:
  - 1.1. Këshilli profesional,
  - 1.2. Kolegjiumi profesional,
  - 1.3. Komisioni disiplinor.

#### **Neni 17**

#### **Këshilli profesional**

1. Këshilli profesional është trup raportues për drejtorin e QPS-së;
2. Këshilli profesional përbëhet nga udhëheqësit e sektorëve;
3. Këshilli profesional nxjerr rregulloren e punës për punën e Këshillit.

#### **Neni 18**

#### **Detyrat e Këshillit Profesional**

1. Këshilli Profesional i QPS-së kryen këto punë dhe detyra:
  - 1.1. I propozon Këshillit të ekspertëve dhe drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë;
  - 1.2. Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme, lidhur me punën e punëtorëve social, si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale;
  - 1.3. Shqyrton nevojën për zhvillim profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e zyrtarëve social për ngritje profesionale;
  - 1.4. Shqyrton dhe vendos lidhur me çështjet tjera, të cilat Drejtori ia parashtron Këshillit të ekspertëve.

#### **Neni 19**

#### **Kolegjiumi profesional**

1. Kolegjiumi profesional themelohet me qëllim të shqyrtimit të çështjeve nga lëmi i punës profesionale të çdo sektori;
2. Kolegjiumin profesional e përbëjnë, Drejtori i QPS-së dhe Udhëheqësit e sektorëve.
3. Kolegjiumi profesional i kryen këto punë:

- 3.1. Shqyrton çështjet lidhur me udhëheqjen e punës profesionale në sektor, merr qëndrim dhe jep propozim lidhur me zgjidhjen e këtyre çështjeve;
- 3.2. Shqyrton dhe jep këshilla dhe përmes Udhëheqësit të Sektorëve, i propozon Këshillit të ekspertëve nevojën dhe arsyeshmerinë profesionale të zbatimit të metodave të reja;
- 3.3. I propozon Këshillit të ekspertëve dhe drejtorit, përmes udhëheqësit të Sektorit, marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë.

#### **Neni 20** **Organizimi sindikal**

1. QPS, mund të themelojë Organizatë sindikale, ku punëtorët, me anëtarësimin e tyre vullnetarë, mund t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e veta të garantuara më konventat ndërkombëtare të punës dhe me Ligj;
2. Në rast greve të punëtorëve në QPS, duhet të sigurohet minimumi i kryerjes së detyrave të punës apo shërbimeve.

#### **Neni 21** **Zhvillimi i vazhdueshëm profesional**

1. Në kuadër të QPS-së, ndërmerren masat për avancim profesional për të gjithë zyrtarët në shërbimin social, bazuar në dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë këtë lëmi;
2. Financimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punëtorëve bëhet nga buxheti i Komunës dhe Ministrisë dhe burimet tjera në dispozicion.

#### **Neni 22** **Mbikëqyrja e QPS-së**

1. QPS, i nënshtrohet mbikëqyrjes ligjore dhe profesionale, që sigurohet përmes organeve të autorizuara në bazë të këtij Statuti dhe dispozitave tjera ligjore;
2. Mbikëqyrjen në QPS-së, përveç organit mbikëqyrës komunal e bënë edhe Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes që vepron në kuadër të MFPT -së;
3. Mbikëqyrja e punës profesionale kryhet në mënyrën e paraparë me Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme të cilën e nxjerr Këshilli i ekspertëve i QPS-së.

#### **Neni 23** **Aktet e përgjithshme**

Aktet e përgjithshme të QPS-së janë: Statuti, rregulloret e Komunës, urdhëresat dhe vendimet, përmes të cilave rregullohen çështjet nga veprimtaria e institucionit.

#### **Neni 24**

##### **Pronësia**

Pasurinë e QPS-së e përbëjnë të drejtat dhe të mirat materiale që kanë qenë të evidentuara si pronë komunale, të cilat QPS, ka pasur të drejtë t'i ketë në dispozicion me datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

#### **Neni 25**

##### **Buxheti**

1. Çështjet buxhetore dhe financiare të QPS-së, administrohen në mënyrë transparente në pajtim me rregulloret dhe procedurat për përdorimin e fondeve nga buxheti i Komunës dhe Buxheti i Republikës së Kosovës dhe me të gjitha procedurat në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
2. QPS, i prezanton buxhetin vjetor për miratim Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për miratim në Kuvendin e Komunës;
3. Më pëlqimin e Drejtorit të DSHMS-së, drejtori i QPS-së, mund të kërkojë revizion të jashtëm, që të monitorojë shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.

#### **Neni 26**

##### **Financimi**

QPS, shfrytëzon burimet financiare, në përputhje me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare në Kosovë nga Buxheti i Republikës së Kosovës, Buxheti i Komunës dhe burimet tjera të parapara me ligjet përkatëse.

#### **Neni 27**

##### **Transparenca në punë**

1. Struktura, kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale, si dhe veprimtaria së QPS-së, janë publike dhe transparente ndaj personave juridik dhe fizik, përveç kur bëhet fjalë për parimin e konfidencialitetit profesional.
2. Informatat dhe të dhënat mbi veprimtarinë, si dhe shikimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e përkujdesjes dhe mirëqenies sociale, personave të autorizuar apo mjeteve të informimit, konform ligjeve në fuqi mund tu jepen vetëm nga Drejtori i QPS-së, ose i punësuar i QPS-së, të cilin e autorizon Drejtori.

**Neni 28**  
**Konfidencialiteti afarist dhe profesional**


1. Zbulimi i sekretit konsiderohet dhënia e dokumentacionit dhe të dhënave të tjera në shikim personave të paautorizuar, veprim i cili do t'i shkaktonte dëm imazhit dhe interesit të QPS-së dhe klientëve që marrin shërbime nga QPS.
2. Konfidencialitet afarist konsiderohen:
  - 2.1. Dokumentet të cilat drejtori i vlerëson si sekret afarist;
  - 2.2. Të dhënat të cilat organi kompetent i konsideron sekrete dhe ia ofron institucionit si të tilla;
  - 2.3. Dokumentacionin që përmban planin e mbrojtjes fiziko-teknike të punonjësve dhe pasurisë së institucionit;
  - 2.4. Të dhënat tjera, publikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e institucionit dhe themeluesit të tij;
3. Konfidencialitet profesional, konsiderohen të dhënat dhe dokumentacioni personal dhe familjarë i klientëve që pranojnë shërbime sociale dhe familjare;
4. Mos ruajtja e konfidencialitetit konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës;
5. Me qëllim të ruajtjes së konfidencialitetit të shërbimeve, në lidhje me jetën personale apo familjare të ndonjë personi në nevojë sociale e që mund të dëmtoi autoritetin e tij, QPS kryen shërbimet/veprimtarinë në objekt të veçantë të ndarë fizikisht nga shërbimet tjera komunale.

**Neni 29**  
**Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Në rast se ekziston konflikt midis dispozitave të këtij Statuti dhe dispozitave të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjit për Skemën e Ndihmës sociale dhe dispozitave të akteve në fuqi që e rregullojnë këtë lëmi, atëherë përparësi kanë dispozitat e këtyre ligjeve.
2. Aktet tjera të përgjithshme të QPS-së, do të nxirren në afat prej 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

**Neni 30**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Statut hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimi të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu  
  
Kryesues i Kuvendit

10